



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 30 Qershor 2022

Nr: 182

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË ORGANIZATËS “QENDRESA QYTETARE” ZJ. EDONA TAFI DREJTOR DHE MJEK I QENDRËS SHËNDETËSORE “RRETHINA” AMBULANCA “DOBRAC” DHE ZJ. MAJLINDA ANGONI KANDIDAT PËR KRYETAR TË BASHKISË SHKODËR PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot më datë 30 Qershor 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim në seancë dëgjimore denoncimin që u përket:

**Kërkues:** Organizata “Qendresa Qytetare”

**Objekt:** Përdorim i aseteve publike në kundërshtim me kufizimet e vendimit nr. 09 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator

**Ndaj:** Zj. Edona Tafa, Drejtor dhe Mjek i Qendrës Shëndetësore “Rrethina”, Ambulaca “Dobraç”

Zj. Majlinda Angoni, Kandidat për Kryetar në Bashkinë Shkodër

**Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, dhe 91, 92, 171, 172, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore,



Data: 30 Qershor 2022

Nr. 182

“Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj zj. Edona Tafa Drejtor dhe Mjek i Qendrës Shëndetësore “Rrethinat”, Ambulanca Dobraç dhe zj. Majlinda Angoni kandidatit për Kryetar të Bashkisë Shkodër propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022”

kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

## VËREN:

### I. Vlerësimi paraprak

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 4 Mars 2022, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të KQZ-së është raportuar denoncimi me numër ID unik 3671, ku pretendohet se: *“Në spotin elektorale të kandidatës së Partisë Socialiste për Kryetare në Bashkinë Shkodër, zj. Majlinda Angoni, spot i cili është postuar në profilin zyrtar të kandidatës, në datë 02.03.2022, shihet qartë nga imazhet se janë përdorur asete dhe burime publike. Konkretisht në sekuençën 00:07, në çelje të spotit, shfaqet mjekja zj. Edona Tafa e cila hyn në ambientet e Qendrës Shëndetësore “Rrethina”, Ambulanca Dobraq dhe në ligjëratën e saj deklaroi mbështetjen për kandidaten zj. Majlinda Angoni, duke shprehur se “...Jam e bindur se një grua multidimensionale si zj. Majlinda Angoni që e ka sprovuar veten në shumë fusha me sukses, është zgjedhja e duhur për një bashki të shkodranëve. Unë votoj Majlinda Angoni...”*

*Për sa më sipër, nga provat bashkëlidhur, shihet se është vënë në mbështetje të kandidatës së PSSH, burime të organeve publike sikurse është Qendra Shëndetësore “Rrethina” Ambulanca Dobraq, duke shkelur parashikimet e nenit 91, pikat 1 dhe 2, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, përkatësisht neni 3 pikat 1.3/c dhe 1.3/ç. Edona Tafa, sikurse shihet nga pamjet merr pjesë në një veprimtari me karakter politik, siç është spoti elektorale i zj. Angoni.*

Bashkëlidhur këtij denoncimi janë dërguar pamjet fotografike nga spoti si dhe provat në link:

<https://www.facebook.com/1058388050/video/1008450100061111/>

2. Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

3. Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:
- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
  - f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
  - n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.
4. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.
5. Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, të dhënat e paraqitura nga denoncuesi Organizata “Qendresa Qytetare”, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative ndaj zj. Edona Tafa Drejtor dhe njëkohësisht Mjeku i Qendrës Shëndetësore “Rrethina”, Ambulanca Dobraq dhe kandidates për Kryetare Bashkie zj. Majlinda Angoni, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
6. Referuar të denoncuarit subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se bazuar në vendimin nr. 19, datë 31. 05.2022 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve ku thuhet se “...në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022 ish-in zgjedhje për kryetar bashkie, por jo për këshillat bashkiake. Për shkak se kandidati për kryetar bashkie trajtohet nga Kodi Zgjedhor si subjekt zgjedhor i mëvetësishëm, atëherë në këto zgjedhje duhet trajtuar subjekt zgjedhor përfitues kandidati dhe jo partia politike që e mbështet atë”. Në këto kushte, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nuk mund të përfshihet në këtë procedim administrativ, pavarësisht se ajo ka qenë subjekt i denoncimit për këtë arsye nuk mund të jetë subjekt i hetimit administrativ.

## II. Rrethanat e faktit

7. Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor nuk lejojnë përdorimin e burimeve të organeve publike në mbështetje të kandidatëve, partive politike apo koalicioneve gjatë fushatës elektorale. Në zbatim të këtyre dispozitave është miratuar edhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator mbi *“Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”*. Në denoncimin e mësipërm pretendohet se objekti i denoncimit bie në kundërshtim me përcaktimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
8. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1558 prot., datë 04.03.2022, i është drejtuar Drejtorit të Qendrës Shëndetësore “Rrethina” ambulanca Dobraq, mjekes zj. Edona Tafa, zj. Majlinda Angoni dhe Partisë Socialiste të Shqipërisë, duke i kërkuar informacion sqarues në lidhje me denoncimin e bërë nga organizata “Qendresa Qytetare” në lidhje me kryerjen e këtij spoti elektorale.
9. Nëpërmjet shkresës protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. 1478 prot., datë 09.03.2022, zj. Angoni bën me dije se konstatimi është i drejtë, por çdo gjë ka ndodhur për shkak të një gabimi nga ana e grupit që ka kompozuar spotin elektorale. Spoti është shpërndarë vetëm në faqen e saj zyrtare “Facebook” dhe nuk është bërë publik në media. Gjithashtu, mjekja zj. Tafa e ka kryer xhirimin e këtij spoti jashtë orarit zyrtar të punës.
10. Nëpërmjet vendimit nr. 13, datë 26.04.2022, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, për shkelje të parashikuara në nenin 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Majlinda Angoni, kandidat për Kryetar të Bashkisë Shkodër e propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Drejtorit të Qendrës Shëndetësore “Rrethina” Ambulanca Dobraq dhe mjekut zj. Edona Tafa, për shkelje administrative të kryera në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.
11. Nëpërmjet shkresës nr. 2348 prot., datë 09.05.2022, shkresat e sipërcituara u janë dërguar për njohje palëve të këtij denoncimi dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, të pikës 15, të

vendimit nr. 9, datë 06.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, subjektet janë njoftuar për të paraqitur prapësimet në lidhje me denoncimin e sipërcituar.

12. Brenda afatit të përcaktuar, Organizata “Qendresa Qytetare” ka depozituar prapësimet e veta nëpërmjet shkresës së datës 16.05.2022, e protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 2433 prot., datë 19.05.2022.
13. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve administroi si material të dosjes hetimore vendimin nr. 62, datë 11.02.2022 “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Shkodër të propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, zj. Majlinda Xhevdet Angoni për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.
14. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2523 prot., datë 31.05.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 31 Maj 2022, ora 13:00, me palë Organizata “Qendresa Qytetare”, Zj. Edona Tafa Drejtor dhe Mjek i Qendrës Shëndetësore “Rrethina” ambulanca Dobraq, dhe zj. Majlinda Angoni, kandidat për kryetar bashkie në Bashkinë Shkodër. Për arsye të ndryshimit të agjendës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, seanca publike u shty për në datën 01.06.2022 ora 10:00, dhe palët u njoftuan nëpërmjet e-mail. Në seancë dëgjimore u paraqitën vetëm pala denoncuese Organizata “Qendresa Qytetare” me përfaqësues të saj zj. Teisa Kurti.
15. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve filloi seancën dëgjimore duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur përfaqësuesit të Organizatës “Qendresa Qytetare” e cila parashtrroi se: *“Referuar denoncimit nr. 3671 ID, Organizata “Qendresa Qytetare” ka raportuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve spotin elektoral të kandidatit të Partisë Socialiste për kryetar bashkie zj. Majlinda Angoni për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, e cila ka postuar në profilin zyrtar të kandidatit në datën 2 Mars 2022, pak ditë para zgjedhjeve ku qartazi shihet se janë përdorur asetet dhe burimet publike. Referuar shkresës kthim-përgjigje të zj. Angoni, pranon shprehimisht se konstatimet e bëra nga denoncimi i Organizatës “Qendresa Qytetare” janë drejta ku sqaron se ka qenë një pakujdesi nga ana e grupit të xhirimit dhe pohon se ky spot është publikuar vetëm njëherë, duke lënë të kuptohet qe zj. Angoni ka qenë e vetëdijshme që ky spot përbënte shkelje. Organizata “Qendresa Qytetare” pretendon se ky spot nuk ka qenë aspak rastësor, por i mirëmenduar. Për këtë sport është vënë në dispozicion Qendra Shëndetësore “Rrethina”, Ambulanca Dobraq, ku siç shihet nga pamjet merr pjesë në një veprimtari me karakter politik,*

*mjekja zj. Edona Tafa e cila deklaroi hapur mbështetjen për zj. Angoni në kundërshtim me nenin 6, pika 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Nga personat përgjegjës është dhënë leja të xhirohet lehtësisht pa asnjë pengesë.*

*Nga konstatimet e bëra në këtë denoncim është pranuar së është përdorur një burim publik sikurse është Qendra Shëndetësore “Rrethina”, duke shkelur parashikimet e nenit 92, të Kodit Zgjedhor. Deklarimet se kompozimi i spotit elektoral ka qenë një pakujdesi nuk e justifikon përdorimin e aseteve publike dhe shkeljen e ligjit. Duke qenë në këto kushte, Organizata “Qendresa Qytetare” gjykon se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe kërkon konstatimin e shkeljeve dhe marrjen e sanksioneve administrative bazuar në nenet 171 dhe 172, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 10, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, ndaj zj. Edona Tafa Drejtor dhe Mjek i Qendrës Shëndetësore “Rrethinat”, Ambulanca Dobraq, subjektit zgjedhor Partia Socialiste dhe ndaj kandidatit për Kryetar Bashkie Shkodër zj. Majlinda Angoni.*

16. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi dëgjoi palët në proces, përfundoi shqyrtimin në tërësi dhe hetimin administrativ duke kërkuar nga palët parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare. Përfaqësuesi i Organizatës “Qendresa Qytetare”, në përfundim të procesit administrativ, i qendroi pretendimeve të tij duke kërkuar marrjen e masave administrative të denoncuarve në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.
17. Nëpërmjet shkresës 2756, datë 20.06.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka njoftuar sërish palët për zhvillimin e seancës dëgjimore, për shkak se palët në proces pretendojnë se nuk kanë marrë në kohë njoftimin për seancën publike dhe nuk kanë mundur të përfaqësohen.
18. Në seancën e datës 28 Qershor 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve riçeli hetimin administrativ duke u dhënë mundësinë palëve të paraqitura për të dhënë pretendimet e tyre. Në seancën dëgjimore u paraqitën pala denoncuese Organizata “Qendresa Qytetare” me përfaqësues të saj zj. Teisa Kurti, kandidati për Kryetar të Bashkisë Shkodër propozuar nga Partia Socialiste për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, zj. Majlinda Angoni dhe avokati i saj përfaqësuar me prokurë të posaçme z. Mariglen Legisi si dhe Drejtori dhe njëkohësisht mjeku zj. Edona Tafa.
19. Organizata “Qendresa Qytetare” i qendroi pretendimeve të saj të parashtruara në seancën e kaluar.
20. Zj. Majlinda Angoni dhe përfaqësuesi i saj sqarojnë se, përsa i përket spotit elektoral të postuar në profilin e saj zyrtar ku është pasqyruar edhe Qendra Shëndetësore Rrethina, zj. Edona Tafa dhe zj. Angoni kanë patur njohje të mëparshme dhe i është kërkuar që të bëhet një kompozim në video dhe në audio për t’i ardhur në ndihmë kandidatës në fushatën elektorale për zgjedhjet e pjesshme

të datës 6 Mars 2022. Video, sikurse referohet në denoncim, nuk është bërë brenda orarit zyrtar të punës, por në orën 17:00. Vizitat pranë kësaj qendre shëndetësore përfundojnë në orën 13:00. Gjithashtu, në deklaratimet e saj zj. Angoni pretendon se nuk është cënuar asnjë lloj interesi publik, interes shëndetësor apo grup individesh. Gjatë kompozimit të videos për spotin elektoral, gabimisht është përdorur emri i Qendrës Shëndetësore.

21. Në pretendimet e saj Drejtori dhe njëkohësisht Mjeku zj. Edona Tafa sqaron se, me zj. Angoni njihemi nëpërmjet angazhimeve të tyre në çështje sociale dhe bashkëpunimit që kanë patur prej vitesh. Lidhur me pretendimet se video është xhiruar brenda orarit zyrtar të punës nuk qendron, pasi video është bërë jashtë këtij orari duke respektuar detyrimet e saj kontraktuale si profesioniste të cilat përfundojnë në mbarimin e orarit zyrtar. Përtej orarit zyrtar është mëse e lejueshme si profesioniste e lirë për të dhënë mbështjen politike pa përdorur asnjë aset publik dhe pa cënuar shërbimin profesional.
22. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi dëgjoi palët në proces, përfundoi shqyrtimin në tërësi dhe hetimin administrativ duke kërkuar nga palët parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare. Përfaqësuesi i Organizatës “Qendresa Qytetare”, në përfundim të procesit administrativ, i qendroi pretendimeve të tij duke kërkuar marrjen e masave administrative të të denoncuarve në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Përfaqësuesi i zj. Angoni dhe zj. Tafa kërkoi rrëzimin e pretendimeve të Organizatës “Qendresa Qytetare.

### III. Analiza ligjore

23. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, në kuptim të pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor i cili parashikon se *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*, veprimtaria e kryer tek Qendra Shëndetësore “Rrethinat”. Në rastin konkret prania e medias dhe veprimet e kryera nga ana e mjekes zj. Edona Tafa nuk lidhen me përmbushjen e detyrës së saj funksionale. Realizimi i një spoti elektoral, brenda mjediseve të një institucioni publik në mbështetje të një kandidati përbën shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, nenit 91 të tij dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020. Vënia në dispozicion të kandidatit të mjediseve të ambulanës dhe regjistrimi audio dhe video ku drejtuesi i institucionit dhe mjekja bën thirrje për të votuar për

kandidaten zj. Angoni, përbën përdorim të burimeve publike në shërbim të fushatës zgjedhore, veprimtari kjo e ndaluar nga ligji.

24. Neni 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor parashikon se, *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”*. Komisioni Rregullator, në vendimin nr. 9/2020 në nenin 3, pika 1.3, nënndarja c, qartësisht ka përcaktuar se, “veprimtari të ndaluar”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: **“vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit”**. Për sa më sipër, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se zj. Tafa në cilësinë e Drejtorit dhe Mjekut të Qendrës Shëndetësore “Rethina”, Ambulaca “Dobraç”, ka shkelur qartazi nenin 91 pika 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor.
25. Neni 91, pikat 1 dhe 2, të Kodit Zgjedhor ndalojnë jo vetëm vënien në dispozicion të burimeve publike nga persona përgjegjës në administrim të tyre, por gjithashtu ndalojnë dhe përdorimin e tyre në funksion të subjekteve zgjedhore apo kandidatëve. Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se zj. Majlinda Angoni, kandidat për Kryetar të Bashkisë Shkodër, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, **me përdorimin e ambienteve të Qendrës Shëndetësore “Rrethinat”, Ambulaca “Dobraç” dhe me përdorimin në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore , përkatësisht të zj. Tafa**, për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore ka përdorur burime publike në mbështetje të fushatës së saj zgjedhore, në kuptim të nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor.
26. Referuar nenit 171 pika 1 *“shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3,000 deri në 90,000 lekë”*, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se zj. Edona Tafa në cilësinë e Drejtorit dhe Mjekut të Qendrës Shëndetësore, me pjesëmarrjen e saj



në këtë spot elektoral si dhe me më vënien në dispozicion të ambienteve të Ambulancës Dobraç, ka konsumuar shkeljen administrative, të parashikuar në nenin 91, të Kodit Zgjedhor

27. Referuar nenit 172, pika 1 e Kodit Zgjedhor “*Subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijani, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Kundërvajtja administrative sipas kësaj pike dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë*”, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se zj. Majlinda Angoni si subjekt zgjedhor, nëpërmjet përdorimit të burimeve publike në fushatën e saj zgjedhore, ka shkelur neni 91.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91 dhe 92, 171, 172 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimi nr. 9, datë 09.03.2021, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve

### **V E N D O S :**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj zj. Edona Tafa Drejtor dhe njëkohësisht mjek i Qendrës Shëndetësore Rrethina, Ambulaca “Dobraç” dhe zj. Majlinda Angoni kandidat për Kryetar Bashkie Shkodër, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.
2. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë.
3. Konstatimin e shkeljes nga ana e zj. Majlinda Angoni, kandidat për kryetar në Bashkinë Shkodër, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
4. Konstatimin e shkeljes nga ana e zj. Edona Tafa, Drejtor dhe Mjek në Qendrën Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Dobraç”.
5. T’i kërkojë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, vendosjen e sanksionit administrative.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 30 Qershor 2022  
Nr. 182

“Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj zj. Edona Tafa Drejtor dhe Mjek i Qendrës Shëndetësore “Rrethinat”, Ambulanca Dobraç dhe zj. Majlinda Angoni kandidatit për Kryetar të Bashksë Shkodër propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022”